



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1287 Prot.

Lezhë, më 31 . 1 . 2024

VENDIM

Nr. 3, Datë 30. 01. 2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIMIN E QIRASË MUJORE PËR VITIN 2024

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë dhe tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministri së përgjegjëse për strehimin. Gjithashtu bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Lezhë Nr.181, datë 23.12.2021 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit dhe programeve sociale të strehimit”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Lezhë Nr. 76, Datë 27.12.2023 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Lezhë Nr. 70 datë 14.12.2023 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxheti Vjetor për vitin 2024” , Relacionin e Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social Nr. 832, datë 23.01.2024 dhe “Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Lezhë Nr. 832/1 për “Miratimin e listës së familjeve përfituese për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2024”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e familjeve që përfitojnë subvencionim të qirasë mujore për vitin 2024 me numër rendor 73, sipas tabelës nr.3 bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi.
2. Në zbatim të këtij vendimi, Bashkia Lezhë t’i paraqesë kërkesën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për financimin e subvencionit të qirasë nga buxheti i shtetit, me afat kohor njëvjeçar.
3. Atyre familjeve, të cilat gjatë periudhës së trajtimit dalin jashtë kriterëve, duke ndryshuar situatën social-ekonomike, u ndërpritet menjëherë përfitimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

EB.
Nr. 1254 prot
dt. 06.02.24

Nr. 108/18 Prot.

Lezhë, më 05.02.2024

Lënda: **Konfirmim vendimi**

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, VKM-në nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM nr. 459, datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 3, datë 30.01.2024 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e qirasë mujorë për vitin 2024".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

